

Instruksion Operacional

PLATFORMA E KREDIDHËNIES DIGJITALE

Produkti
Kredia Konsumatore
e Pasiguruar



HYRJA NË PLATFORMËN DIGJITALE TË TIRANA BANK


Hapni faqen e hyrjes në platformën digjitale të Tirana Bank.
(Udhëzimet shoqëruese janë të ilustruara me pamje ekrani.)

1. Plotësoni:

- Emrin e përdoruesit
- Fjalëkalimin

2. Klikoni butonin "Hyr".

- Këshillë: Nëse nuk e mbani mend fjalëkalimin, klikoni te "Po has ndonjë vështirësi?" për rikuperim.
- Përdorues i ri? Klikoni "Regjistrohu në platformën digjitale" për të krijuar një llogari.



English ▾

Log in to online banking

You'll need your username and password

Username

Password

Login

Having problems? ▾

New to online banking? [Register for online banking](#)

FAQJA KRYESORE (DASHBOARD)

Pasi klienti hyn në platformën digjitale, në ekran shfaqet Faqja kryesore (Dashboard).


Paneli është i organizuar në disa menu kryesore:

- Faqja kryesore
- Transferta
- Llogari
- Të dhëna
- Vetëshërbim
- Produkte


Në krye të faqes ndodhet menuja e navigimit.

Për të nisur procesin e aplikimit për kredi konsumatore të pasiguar, klienti duhet të zgjedhë menunë “Produkte”.

Pas klikimit, shfaqen opsionet e disponueshme për aplikim.




Në panelin në të djathtë, klienti mund të zgjedhë gjuhën Shqip ose Anglisht, të ofruara nga platforma.



APLIKO PËR KREDI OSE KARTË KREDITI

Për të vazhduar me aplikimin, klienti duhet të zgjedhë opsionin “Apliko për Kredi ose Kartë Kreditit”.

Ky veprim e çon në hapin tjetër, ku mund të zgjedhë llojin e produktit për të cilin dëshiron të aplikojë.



Zgjedhja e produktit


Në këtë hap, klienti shfaqet në faqen "Produkte", ku ofrohen dy opsione aplikimi:

- Kredi Konsumatore e Pasiguar
- Kartë Krediti

Secili produkt paraqitet me një përshkrim të shkurtër dhe me butonin për nisjen e aplikimit.

Për të vijuar me aplikimin për Kredi Konsumatore të Pasiguar, klienti duhet të zgjedhë kutinë përkatëse të produktit.

Zgjedhja e këtij opsioni hap formularin digjital të aplikimit dhe hapat e mëtejshëm që duhen ndjekur për përfundimin e procesit online. Klienti udhëhiqet hap pas hapi për plotësimin e të dhënave dhe dërgimin e aplikimit për vlerësim.



Nëse klienti ka nevojë për më shumë informacion mbi produktin, mund të klikojë "Më shumë detaje" për të parë kushtet dhe specifikimet e kredisë konsumatore të pasiguar.

Ky dokument është informues dhe nuk është i detyrueshëm, duke mos penguar vijimin e aplikimit.



Pas klikimit, hapet faqja informuese e dedikuar për produktin, e cila përmban: karakteristikat kryesore të kredisë, si dhe informacion mbi dokumentacionin e nevojshëm për aplikim.

Dokumentacioni i nevojshëm


Klienti duhet të disponojë dokumentet e mëposhtme:

- Vërtetim për kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore (për individin)
- Vërtetim page
- Certifikatë familjare

APLIKIMI PËR KREDI KONSUMATORE TË PASIGURUAR

Klienti zgjedh të nisë procesin për Kredi Konsumatore të Pasiguar duke klikuar mbi butonin “Le të fillojmë”.

Pas këtij veprimi, shfaqet një faqe e dedikuar që liston dokumentet e detyrueshme për të vijuar me aplikimin online.



Dokumentet e nevojshme

Faqja përmban tre elemente kryesore:

- Vërtetim page

Dokument që tregon të ardhurat mujore të aplikuesit. Mund të gjenerohet përmes platformës e-Albania, duke klikuar lidhjen përkatëse.

- Vërtetim për pagimin e kontributeve për individin

Dokument që vërteton kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Gjenerohet nga e-Albania përmes lidhjes së ofruar.


- Certifikatë familjare

Dokument i nevojshëm për të konfirmuar përbërjen familjare të aplikuesit. Sigurohet gjithashtu nga e-Albania përmes lidhjes përkatëse.

Qëllimi i këtij hapi është që klienti të sigurohet se i ka të gjitha dokumentet gati për ngarkim ose verifikim përpara se të vazhdojë me aplikimin.

Në fund të faqes shfaqet butoni “Fillo”, i cili e drejton klientin drejt formularit të aplikimit.

HAPI 1: RISHIKIMI I DOKUMENTACIONIT PËR KUSHTET E KREDISË



Pasi klienti ka kaluar fazën e informimit mbi dokumentet e nevojshme, shfaqet faqja ku duhet të rishikohen kushtet dhe dokumentacioni për Kredinë Konsumatore të Pasiguruar.

Ky është një hap i detyrueshëm, i cili siguron që klienti të jetë njohur me të gjitha termat përpara se të vijojë me aplikimin.

Dokumenti i kushteve

Në këtë seksion shfaqet dokumenti:

“Kushtet e Punës së Kredisë Konsumatore të Pasiguruar”

Klienti duhet:

- të hapë dokumentin përmes lidhjes së dhënë;
- të rishikojë përmbajtjen përpara se të vazhdojë.

Sistemi nuk lejon vijimin e procesit pa u hapur dhe lexuar ky dokument.

Deklarata e pranimit

Në pjesën e poshtme të faqes paraqitet kutia e konfirmimit:

“Pranoj që kam lexuar dokumentacionin e përmendur më sipër”

Kjo kuti duhet të shënohet detyrimisht për të vazhduar në hapin tjetër.


Duke e përzgjedhur këtë kuti dhe duke klikuar butonin “Vazhdo”, klienti:

- konfirmon që është njohur me dokumentacionin;
- jep pëlqimin për përdorimin e nënshkrimit elektronik, i cili ka të njëjtin efekt ligjor si nënshkrimi me dorë.

Ky hap është thelbësor, pasi përmbledh përgjegjësitë, tarifat, kushtet e përdorimit dhe të drejtat e klientit në lidhje me kredinë për të cilën po aplikon.

PËRLLOGARITËSI I KREDISË

Në këtë hap, klienti përcakton parametrat kryesorë të kredisë që dëshiron të aplikojë.




- Vendos shumën e kredisë që dëshiron të marrë.
 - Zgjedh kohëzgjatjen e kredisë duke lëvizur slider-in sipas preferencës.
 - Kësti mujor llogaritet automatikisht, bazuar në shumën dhe afatin e zgjedhur.
- Shfaqen detajet kryesore të kredisë, si:
- norma e interesit,
 - komisioni,
 - periudha e shlyerjes.

Pasi të përcaktojë parametrat, klienti klikon butonin “Vazhdo” për të kaluar në hapin tjetër të aplikimit.

PËRZGJEDHJA E KOMPANISË SË SIGURIMIT TË JETËS

Në këtë hap, klienti zgjedh kompaninë e sigurimit të jetës, e cila është e nevojshme për finalizimin e kredisë.



- Hapet lista me kompanitë e sigurimit të jetës të disponueshme.
 - Shfaqet përqindja e primit për secilën kompani (p.sh. 1.2%).
 - Klienti zgjedh kompaninë e preferuar nga lista.
- Kjo zgjedhje është e detyrueshme për të vijuar procesin e aplikimit online.

Shënim:

Nëse klienti dëshiron të ushtrojë të drejtën për të kryer sigurimin e jetës drejtpërdrejt me një kompani sigurimi, pa ndërmjetësimin e Tirana Bank, aplikimi për kredi nuk mund të përfundojë online dhe duhet të vijojë në një nga degët fizike të bankës.

RISHIKIMI I DOKUMENTACIONIT

Klienti duhet të rishikojë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Klauzola e pëlqimit paraprak
- Deklarata për përpunimin e të dhënave
- Klauzola për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave
- Klauzola për metodën e përpunimit të të dhënave

Butoni "Prano" aktivizohet dhe mund të klikohet vetëm pasi klienti të ketë hapur, lexuar, dhe rishikuar të gjitha dokumentet e listuara në këtë faqe.

Platforma monitoron hapjen e secilit dokument individualisht dhe lejon kalimin në hapin e ardhshëm vetëm pasi të gjitha dokumentet të jenë rishikuar.

Rishiko dokumentacionin

Përpara aplikimit, sigurohu që ke lexuar dhe pranuar dokumentacionin e listuar si më poshtë.

📌 Nëse ke pyetje në lidhje me përbajtjen e dokumentacionit, na kontakto në +355 4 22 77 700 ose vizito një degë

- **Klauzola e pëlqimit paraprak**
Të lutem lexo dhe rishiko dokumentacionin për të vijuar më tej.
- **Deklarata e përpunimit të të dhënave**
Të lutem lexo dhe rishiko dokumentacionin për të vijuar më tej.
- **Klauzola e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave**
Të lutem lexo dhe rishiko dokumentacionin për të vijuar më tej.
- **Klauzola e metodës së përpunimit të të dhënave**
Të lutem lexo dhe rishiko dokumentacionin për të vijuar më tej.

Pranoj që kam lexuar dokumentacionin e përmendur më sipër
Duke klikuar kullinë dhe butonin "Vazhdo" më poshtë, po përdor nënshkrimin tim elektronik që ka të njëjtin efekt ligjor si nënshkrimi me dorë dhe provon pëlqimin tim të dhënë sipas përbajtjes së dokumentacionit të listuar më sipër.

Vazhdo

Në këtë hap, klienti konfirmon se është njohur me dokumentacionin e detyrueshëm dhe është gati të vijojë me aplikimin.

Rishiko dokumentacionin

Përpara aplikimit, sigurohu që ke lexuar dhe pranuar dokumentacionin e listuar si më poshtë.

📌 Nëse ke pyetje në lidhje me përbajtjen e dokumentacionit, na kontakto në +355 4 22 77 700 ose vizito një degë

- ✓ **Klauzola e pëlqimit paraprak**
Të lutem lexo dhe rishiko dokumentacionin për të vijuar më tej.
- ✓ **Deklarata e përpunimit të të dhënave**
Të lutem lexo dhe rishiko dokumentacionin për të vijuar më tej.
- ✓ **Klauzola e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave**
Të lutem lexo dhe rishiko dokumentacionin për të vijuar më tej.
- ✓ **Klauzola e metodës së përpunimit të të dhënave**
Të lutem lexo dhe rishiko dokumentacionin për të vijuar më tej.

Pranoj që kam lexuar dokumentacionin e përmendur më sipër
Duke klikuar kullinë dhe butonin "Vazhdo" më poshtë, po përdor nënshkrimin tim elektronik që ka të njëjtin efekt ligjor si nënshkrimi me dorë dhe provon pëlqimin tim të dhënë sipas përbajtjes së dokumentacionit të listuar më sipër.

Vazhdo

HAPI 2: TË DHËNAT PERSONALE – INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Në këtë hap, klienti plotëson informacionin bazë familjar dhe të banimit, i cili është i nevojshëm për vlerësimin e aplikimit për kredi.

Informacion i përgjithshëm

Numri i anëtarëve të familjes mbi 18 vjeç
1

Numri i fëmijëve nën 18 vjeç
0

Zona e banimit
Tiranë

Statusi i banimit
Në pronësi

Qëllimi i kredisë
Financim për pushime

Kodi promocional (optional)

- Vendos numrin e anëtarëve të familjes mbi 18 vjeç.
- Plotëson numrin e fëmijëve nën 18 vjeç.
- Zgjedh zonën e banimit (urbane/rurale).
- Përcakton statusin e banimit (në pronësi, me qira, etj.).
- Zgjedh qëllimin e kredisë nga lista e opsioneve.
- Vendos kodin promocional, nëse disponon një të tillë (opsionale).
- Pasi plotësohen të gjitha të dhënat e kërkuara, klienti klikon butonin “Vazhdo” për të kaluar në seksionin vijues.

TË DHËNA MBI PUNËSIMIN

Në këtë seksion, klienti jep të dhënat kryesore që lidhen me punësimin e tij aktual.

Të dhëna mbi punësimin

Lloji i punësimit
Specialist

Lloji i kontratës
Me kohë të pakufizuar

Sektori i punësimit
Kompani Private

Sektori i industrisë
Pasuri të paluajtshme

Pasuri të paluajtshme, qira dhe aktivitete biznesi
Hulmtime dhe zhvillime eksperimentale në shkencat shoqërore

A merr të ardhura mujore nga një punë tjetër përveç asaj kryesore, ose ke ndryshuar punëdhënësin gjatë gjashtë muajve të fundit?

- Përzgjedh llojin e punësimit (p.sh. specialist, punëtor, drejtues).
- Zgjedh llojin e kontratës (afatgjatë, pa afat, afatshkurtër).
- Përcakton sektorin ku punon (privat, shtetëror, etj.).

- Zgjedh industrinë ku bën pjesë punëdhënësi.
- Nëse industria ka nënkategori, përzgjedh opsionin përkatës.

Kujdes! (Logjika e aktivizimit)

Opsioni për të deklaruar të ardhura shtesë ose ndryshime në punësim aktivizohet vetëm në rastet kur:

- Klienti ka një punësim të dytë të siguruar, ose
- ka pasur punësim të njëpasnjëshëm gjatë 6 muajve të fundit.
- Në mungesë të këtyre kushteve, opsioni mbetet i çaktivizuar dhe nuk kërkohet plotësim shtesë.

Pasi plotësohen të dhënat, klienti klikon butonin “Vazhdo” për të kaluar në seksionin pasues.

TË DHËNA MBI SHPENZIMET

Në këtë seksion, klienti deklaron nëse ka shpenzime të tjera mujore të konsiderueshme.

Klienti aktivizon opsionin përkatës në rast se ka shpenzime shtesë që ndikojnë në buxhetin e tij.

Plotësimi i shpenzimeve

Nëse opsioni aktivizohet, shfaqen fushat për plotësim:

- Përzgjedh llojin e shpenzimit nga lista.
- Plotëson shumën mujore të shpenzimit.
- Zgjedh monedhën në të cilën paguhet shpenzimi (p.sh. ALL, EUR).

Klienti ka mundësinë të:

Rikthehet në ekranin e mëparshëm duke klikuar “Kthehu”, ose të vijojë procesin duke klikuar “Vazhdo”.

NGARKIMI I DOKUMENTEVE

Në këtë seksion, klienti duhet të ngarkojë tre dokumentet zyrtare të kërkuara për vlerësimin e aplikimit.

Çdo dokument duhet:

- të jetë në format PDF;
- të jetë i shkarkuar nga platforma e-Albania;
- të ketë datë të vlefshme.

DOKUMENTET E KËRKUARA

Ngarko dokumentet

Vërtetim page për punësimin kryesor
Data e dokumentit duhet të jetë e njëjtë me datën e ngarkimit të dokumentit në platformën digjitale

[Shto dokumentet ose vijo me ngarkimin](#)
Përdor vetëm dokumente të tipit PDF (Madhësia maksimale 2.9 MB).
Numri maksimal i dokumenteve që mund të ngarkohen është 1 dokument.

Kontributi i Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore për Individin për punësimin kryesor
Data e dokumentit duhet të jetë e njëjtë me datën e ngarkimit të dokumentit në platformën digjitale

[Shto dokumentet ose vijo me ngarkimin](#)
Përdor vetëm dokumente të tipit PDF (Madhësia maksimale 2.9 MB).
Numri maksimal i dokumenteve që mund të ngarkohen është 1 dokument.

Certifikatë familjare

[Shto dokumentet ose vijo me ngarkimin](#)
Përdor vetëm dokumente të tipit PDF (Madhësia maksimale 2.9 MB).
Numri maksimal i dokumenteve që mund të ngarkohen është 1 dokument.

Sistemi paraqet tre seksione të veçanta:

- Vërtetim page për punësimin kryesor.

Dokument që tregon të ardhurat mujore të klientit.

Shkarkohet nga: e-Albania → Vërtetim page

- Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Dokument për individin, i përditësuar.

Shkarkohet nga: e-Albania → Statusi i kontributeve

- Certifikatë familjare.

Dokument zyrtar për përbërjen familjare.

Shkarkohet nga: e-Albania → Certifikata familjare

Çdo seksion përmban butonin:

“Shto dokumentet” / “Vijo me ngarkimin”

Klienti duhet të ngarkojë nga një dokument për secilin seksion.

Sistemi nuk lejon ngarkimin e më shumë se një dokumenti për çdo seksion.


Statusi i ngarkimit

Pas ngarkimit të suksesshëm, në secilin seksion shfaqet statusi:

“Përfundoi” – Dokumentet u ngarkuan me sukses.


HAPI 3: RISHIKIMI I OFERTËS

Në këtë hap sistemi është duke përpunuar të gjitha informacionet e dhëna dhe dokumenteve të ngarkuara nga përdoruesi.



PROCESI I RISHIKIMIT TË TË DHËNAVE

Në ekran shfaqet një mesazh që informon klientin për përpunimin e kërkesës.



Gjatë kësaj faze kryhet:

- verifikimi i të dhënave personale;
- kontrolli i dokumentacionit të paraqitur;
- analiza e aplikimit për përcaktimin e ofertës përkatëse.

Sapo verifikimet përfundojnë, sistemi njofton klientin automatikisht, në varësi të rezultatit të aplikimit.

OFERTË E PERSONALIZUAR PËR TY



Pasi sistemi përpunon të gjitha të dhënat dhe dokumentet e klientit, shfaqet ekrani me ofertën finale të personalizuar për kredinë konsumatore të pasiguruar.

Ky është një nga hapat më të rëndësishëm të procesit, pasi klienti duhet të zgjedhë njërën nga alternativat e propozuara.

Zgjedhja e ofertës

Në këtë fazë, sistemi mund të:

- miratojë kërkesën sipas shumës së kërkuar, ose
- sugjerojë një shumë më të lartë ose më të ulët, bazuar në vlerësimin e aftësisë paguese, të ardhurave dhe dokumentacionit.


Klienti duhet të zgjedhë njërën nga ofertat duke klikuar rrethin përkatës në të majtë të secilit opsion.

Sistemi nuk lejon vijimin e procesit pa u përzgjedhur një ofertë.

Pasi bëhet zgjedhja, klienti klikon butonin “Vazhdo” për të kaluar në hapin tjetër.

RISHIKIMI I DOKUMENTACIONIT

Në këtë fazë, klienti duhet të sigurohet që ka lexuar dhe pranuar dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e aplikimit. Seksioni paraqet të gjithë informacionin që duhet të merret në konsideratë përpara vazhdimin.



Lexoni me kujdes dokumentacionin e listuar në këtë hap

Këtu përfshihet dokumentacioni informues dhe kushtet përkatëse të produktit.

- Klikoni mbi linkun “Informacion parakontaktor” për të parë detajet e dokumenteve dhe konfirmoni brenda dokumentit përkatës.
- Vendosni shenjën ✓ te kutia e konfirmimit:
- “Pranoj që kam lexuar dokumentacionin e përmendur më sipër”


Ky hap është i detyrueshëm për të vijuar me aplikimin.

Pasi të përfundojë rishikimi, klienti klikon butonin “Vazhdo” në fund të faqes.

Përmbledhja e aplikimit

Në këtë hap, klienti rishikon përmbledhjen finale të parametrave të kredisë përpara dërgimit të aplikimit.

Të gjitha të dhënat financiare dhe kushtet e kredisë paraqiten në mënyrë të qartë, për të siguruar që aplikanti i ka verifikuar saktë përpara konfirmimit.



Në këtë hap paraqitet një përmbledhje e plotë e kredisë, duke përfshirë:

- shumën e kredisë,
- afatin e shlyerjes,
- këstin mujor.

Gjithashtu shfaqen kostot totale të kredisë, si:


- norma e interesit,
- komisioni administrativ,
- primet e sigurimit,
- norma efektive e interesit (EIR).

Pasi verifikon çdo detaj, klienti klikon butonin “Konfirmo” për të dërguar aplikimin për vlerësim.

Ky hap përmbyll seksionin e të dhënave dhe e drejton klientin drejt procesit të vlerësimit të ofertës.

PRANIMI I OFERTËS SË APLIKIMIT

Në këtë hap paraqitet një mesazh konfirmimi, i cili siguron që klienti pranon kushtet e kredisë përpara dërgimit final të aplikimit.




Shfaqet një dritare popup me pyetjen:

- “E pranon ofertën e kredisë?”
- Mesazhi informon se, në rast konfirmimi, aplikimi do të dërgohet për vlerësimin përfundimtar.
- Butoni “Kthehu” i lejon klientit të rishikojë informacionin përpara pranimit.
- Butoni “Dërgo” finalizon konfirmimin dhe e dërgon aplikimin drejt fazës së vlerësimit të brendshëm.

Pas klikimit të “Dërgo”, klienti nuk mund të ndryshojë më të dhënat e aplikimit.

HAPI 4: VLERËSIMI I OFERTËS

Në këtë fazë kryhen kontrollet finale për të siguruar përputhshmërinë e të dhënave dhe vlefshmërinë e ofertës përpara vendimit përfundimtar mbi aplikimin.



Gjatë këtij procesi realizohet:

- verifikimi përfundimtar i të dhënave të klientit;
- kontrolli i dokumentacionit të paraqitur;
- vlerësimi i ofertës sipas analizës së brendshme.
- Pasi përfundon shqyrtimi, sistemi e ridrejton automatikisht klientin në hapin pasues, pa pasur nevojë për veprime shtesë.

Rasti kur aplikimi refuzohet nga sistemi

Në rastet kur sistemi kryen vlerësimin automatik dhe rezultati është **“Loan not approved”**, klienti ridrejtohet në faqen përfundimtare të statusit, ku shfaqet njoftimi për refuzimin e aplikimit.

Elementet kyçe të ekranit të refuzimit

Ekрани paraqet:

- statusin përfundimtar “Loan not approved”;
- një mesazh informues që njofton klientin për refuzimin e aplikimit;
- butonin “Close” për mbylljen e pamjes.



SJELLJA E SISTEMIT

Sistemi nuk lejon vijimin e procesit brenda platformës, pasi aplikimi konsiderohet i mbyllur.

Klienti udhëzohet të kontaktojë degën më të afërt të Tirana Bank për informacion shtesë ose për alternativa të tjera aplikimi.

Rasti kur aplikimi dërgohet për vlerësim në Credit Risk Department

Në disa raste, sistemi nuk jep një vendim të menjëhershëm dhe aplikimi kalon në vlerësim manual.

- Klienti njoftohet se aplikimi është në proces vlerësimi.
- Të dhënat dhe dokumentacioni kalojnë automatikisht në Credit Risk Department për shqyrtim manual.

Në këtë fazë, klienti nuk ka veprime shtesë për të kryer brenda platformës.

Hapat që ndjek klienti

- Klienti pret komunikimin zyrtar nga banka (telefonatë ose e-mail), ku do të njoftohet për statusin ose kërkesat e mëtejshme, brenda maksimumi 1 dite pune.
- Klienti ndjek udhëzimet e dhëna nga Credit Risk Department për informacion ose dokumentacion shtesë.
- Në rast miratimi, klienti njoftohet për hapat e mëtejshëm dhe vijon procesin sipas udhëzimeve të bankës.

Njoftimi për miratimin e kredisë

Në rast aprovimi të kredisë, sistemi njofton klientin përmes një mesazhi pop-up brenda platformës.

Ky njoftim:

konfirmon miratimin e aplikimit;

udhëzon klientin të aksesojë platformën për të vijuar procesin.

Vijimi i procesit në platformë


Pasi klienti hyn në platformë:

- Navigon te seksioni “Produkte”
- Zgjedh produktin “Kredia Konsumatore”
- Sistemi shfaq një dritare informuese që i jep akses për të vazhduar aplikimin

Mesazhi i konfirmimit


Pasi hyn në seksionin e kredisë konsumatore, klientit i shfaqet një mesazh i dedikuar, si:

Në rast refuzimi të kredisë, sistemi njofton klientin përmes një mesazhi pop-up brenda platformës.



Ky njoftim:

- informon klientin se aplikimi nuk është aprovuar;
- e udhëzon të kontaktojë bankën për informacione të mëtejshme.




Në ekran shfaqet statusi:

“Loan not approved”, së bashku me opsionet për të kontaktuar bankën (Email ose Phone), duke i mundësuar klientit të marrë asistencë mbi arsyet e refuzimit ose alternativat e mundshme.

Aksesimi i informacionit në platformë


Klienti duhet të identifikohet duke përdorur kredencialet e tij. Pasi të ketë hyrë:

- Navigon te seksioni “Produkte”
- Zgjedh produktin “Kredia Konsumatore”
- Sistemi shfaq një dritare informuese me statusin e Aplikimit



Mesazhi i refuzimit

Pasi hyn në seksionin e kredisë konsumatore, klientit i shfaqet një mesazh i dedikuar që konfirmon se kredia nuk është aprovuar dhe e udhëzon për hapat e mëtejshëm, si kontaktimi me bankën për asistencë.




HAPI 5: NËNSHKRIMI ELEKTRONIK

Në këtë faqe, klientit i kërkohet të kryejë verifikimin e identitetit për të mundësuar nënshkrimin elektronik të dokumenteve të kredisë.

Në ekran shfaqet titulli:


“VERIFIKIMI I IDENTITETIT”, i cili informon klientin për nevojën e kryerjes së këtij procesi për të vijuar me aplikimin.



Informacion për klientin

Sistemi informon klientin se:

- identiteti duhet të verifikohet për arsye sigurie;
- procesi realizohet në mënyrë digjitale dhe është plotësisht i automatizuar;
- rekomandohet përdorimi i telefonit celular për një përvojë më të lehtë dhe më të shpejtë



Afati kohor: Klienti informohet se dokumentet duhet të nënshkruhen brenda 48 orëve nga momenti i këtij njoftimi.

Leximi i certifikatës së dispozicionit

Në këtë faqe, klienti njoftohet mbi kushtet e lëshimit dhe përdorimit të certifikatës elektronike, e cila përdoret për nënshkrimin elektronik të dokumenteve të kredisë.

Ky hap është i detyrueshëm për të vijuar me procesin e nënshkrimit elektronik.

Lëshimi i certifikatës së disponueshme

ISSUE OF DISPOSABLE CERTIFICATES - APPLICATION FORM - Mod NAM CA22_KOS (Rev.01)

Ju aplikoni për një kontratë për lëshimin e një certifikate elektronike të kualifikuar të disponueshme për t'u ekzekutuar midis justh (kërkuessit) dhe Namirial SpA, një kompani italiane që ka zyrën e saj të regjistruar në Sengallia (AN), Kod Zp 60019, Via Caduti Sul Lavoro No. 4, Italia, Regjistri i Tregtisë dhe Kompanive të Ankonës dhe Kodit Tatimor/Numri VAT Nr. 02046570426 (në C/Tues i Shërbimit të Mirëbesimit të Kualifikuar sipas Regjules së eIDAS).

Ky aplikacion që do të përbushni do të dërgohet në Namirial nga Autoriteti Lokal i Regjistrimit (siç përcaktohet në Shtojcën A më poshtë) në mënyrë që tju ofrojë një të disponueshme certifikate e kualifikuar elektronike e nënshkrimit që ju lejon të nënshkruani në mënyrë elektronike një kontratë brenda kufizimeve të përdorimit të përcaktuara në Shtojcën C më poshtë (duke pasur efektin ekuivalent ligor të një nënshkrimi të shikuar me dorë). Sipas përkufizimeve të kësaj Kontrate të lëshimit, Ju jeni emëruar si Mbajtës i Certifikatës.

ORARI A – Autoriteti Lokal i Regjistrimit (LRA) detajet
LRA Nr (Autoriteti i Regjistrimit Lokal): 1105
kompania/emri (i fundit, i parit, i mesëm): XYZMO DEMO
kodi i taksave: 00448866559 numri vat: 00448866559

ORARI B – Detajet e mbajtësit
Z (Znj) - emri/mbiemri: PANAJOT BALI Numri personal i identifikimit: I75306005M
Email: PBAJ@TEST.AL telefon: +355694116384

ORARI C – Furnizimi dhe çmimi
Lëshimi i një Certifikate të disponueshme, e karakterizuar nga një kohëzgjatje e kufizuar prej 60 minutash dhe përdorimi i së cilës është i kufizuar brenda fushës së mëposhtme:
L utilizzo del certificato è limitato ai rapporti con XYZMO DEMO/The certificate may be used only for relations with the XYZMO DEMO
Kostoja e shërbimit do të sigurohet nga vetë LRA.

LOADIT.D - Kushtet dhe kushtet e furnizimit

Për të nënshkruar me nënshkrim elektronik Formularin e Aplikimit, duhet të pranoni termat dhe kushtet duke kontrolluar kutitë e mëposhtme:

(1) Unë vërtetoj përmbajtjen e ORARI E – VETË-CERTIFIKIMI DHE NËNSHKRIMI NGA MBAJTËSIT

(2) Unë pranoj Termat dhe Kushtet e Përgjithshme (Mod.NAMCA01D) dhe klauzolat e njëanshme të përcaktuara në ORARI F – KLAUZOLAT ME NJË ANË

KAPËRCE ANULO PRANO

Qëllimi i certifikatës

- Certifikata elektronike përdoret për realizimin e nënshkrimit elektronik.
- Certifikata lëshohet nga një ofrues i autorizuar (Namirial).
- Certifikata ka një afat vlefshmërie të kufizuar dhe përdoret vetëm për qëllimet e përcaktuara.

Përmbajtja e dokumentit:

- identifikimin e mbajtësit të certifikatës;
- kushtet e përdorimit dhe kufizimet e saj;
- të drejtat dhe detyrimet e palëve të përfshira në procesin e nënshkrimit elektronik.

Opsionet e klientit

- “Refuzo”

Ndërpret procesin e nënshkrimit elektronik dhe aplikimi nuk vijon.

- “Anulo”

Rikthen klientin në hapin e mëparshëm pa përfunduar veprimin.

- “Prano”

Konfirmon pranimin e certifikatës dhe termave, duke lejuar vazhdimin e procesit.

Vetëm pas klikimit të “Prano”, sistemi kalon në fazën e radhës: verifikimi i identitetit dhe nënshkrimi elektronik.

PRANIMI I NJOFTIMIT PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE (GDPR)

Në këtë faqe, pasi klienti klikon butonin “Identifikohu”, i paraqitet dokumenti i privatësisë (GDPR), i cili shpjegon mënyrën e mbledhjes, përpunimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Klienti duhet të lexojë informacionin dhe të zgjedhë nëse pranon apo refuzon kushtet e përpunimit të të dhënave.


Në fund të faqes shfaqen dy opsione:

- “Refuzo dhe dil”, nëse klienti nuk dëshiron të vazhdojë me procesin;
- “Pranoj”, për të vijuar në hapin e radhës të aplikimit.

VERIFIKIMI I IDENTITETIT

Në këtë faqe, klientit i kërkohet të kryejë verifikimin e identitetit për të mundësuar nënshkrimin elektronik të dokumenteve të kredisë.

Ky hap është i detyrueshëm dhe garanton sigurinë, vlefshmërinë ligjore dhe integritetin e procesit.



Informacion për klientin

- identiteti duhet të verifikohet për arsye sigurie;
- procesi realizohet në mënyrë digjitale;
- rekomandohet përdorimi i telefonit celular për një përvojë më të lehtë dhe më të shpejtë.

Mënyra e verifikimit

Klienti ka dy mundësi për të vijuar procesin:

- Vazhdo në celular
- Klienti klikon butonin "Vazhdo në celular"
- Sistemi ridrejton procesin në telefonin celular
- Në celular kryhen hapat e nevojshëm për identifikim (të njëjtë me procesin në kompjuter)
- Vazhdo në kompjuter
- Klienti klikon linkun "kliko këtu"
- Procesi vijon në kompjuterin që po përdor.

IDENTIFIKIMI ELEKTRONIK (VERIFIKIMI I IDENTITETIT)

Në këtë faqe, klientit i kërkohet të kryejë verifikimin biometrik të identitetit përmes platformës Namirial.


Ky hap është thelbësor për të garantuar sigurinë, besueshmërinë dhe vlefshmërinë ligjore të procesit të identifikimit dhe nënshkrimit elektronik.

Procesi siguron që personi që firmos dokumentet është vetë aplikuesi.




Namirial

Për të verifikuar identitetin tuaj, duhet të skanoni



Dokumentin tuaj të identitetit



Fytyrën tuaj

FILLONI

Fillimi i procesit

Për të nisur verifikimin:

- Klienti klikon butonin "FILLONI";
- sistemi aktivizon procesin e identifikimit biometrik;
- verifikimi realizohet përmes kamerës së pajisjes.
- Hapat gjatë verifikimit

Gjatë procesit, klienti duhet:

- të lejojë aksesin në kamerë;
- të pozicionohet përpara kamerës sipas udhëzimeve në ekran (distancë, ndriçim dhe kënd i duhur);
- të skanojë fytyrën dhe dokumentin e identitetit, duke e mbajtur atë të qartë dhe të lexueshëm.

Procesi është i automatizuar dhe zgjat vetëm disa sekonda.

Siguria dhe privatësia

Sistemi garanton se:

- të dhënat biometrike përdoren vetëm për qëllime verifikimi;
- informacioni përpunohet dhe trajtohet në përputhje me ligjin nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale";
- të dhënat nuk përdoren për qëllime të tjera.

Vazhdimi i procesit

- Pas përfundimit me sukses të verifikimit Identiteti i klientit konfirmohet përmes verifikimit biometrik.

- Të dhënat biometrike përdoren vetëm për qëllime verifikimi gjatë procesit të nënshkrimit elektronik.
- Informacioni përpunohet në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale, përfshirë standardet e sigurisë dhe kërkesat e GDPR.
- Të dhënat nuk përdoren për qëllime të tjera, nuk ndahen me palë të paautorizuara dhe nuk ruhen më gjatë se sa është e nevojshme për procesin e verifikimit.


Pas këtij hapi, sistemi lejon vijimin e procesit të nënshkrimit elektronik.

Në rast se verifikimi nuk përfundon me sukses:

- Klienti njoftohet për dështimin e verifikimit.
- Sistemi e udhëzon klientin të përsërisë procesin.

Pamja e ekranit

Faqja e shfaqur në web (kompjuter)



Faqja e shfaqur në telefon celular




Zgjedhja e dokumentit të identitetit

Në këtë faqe, klientit i kërkohet të zgjedhë llojin e dokumentit të identitetit që do të përdorë për verifikimin biometrik.

Ky hap është i domosdoshëm për të nisur procesin e skanimit dhe për të siguruar që dokumenti i zgjedhur është i vlefshëm dhe i pranueshëm nga sistemi.

Në ekran shfaqet titulli:
“Zgjedhja e dokumentit”



Opsionet e dokumentit

Sistemi paraqet listën e dokumenteve që mund të përdoren për verifikim biometrik. Klienti mund të zgjedhë një nga opsionet e mëposhtme:

- Kartë identiteti (ID Card) dokumenti standard i identifikimit, i vlefshëm dhe i pranuar për verifikim biometrik.
- Pasaportë dokument udhëtimi dhe identifikimi, që mund të përdoret edhe në mungesë të kartës së identitetit.

Kërkesat për dokumentin

Klienti duhet të zgjedhë vetëm një dokument, i cili duhet të jetë:

- i vlefshëm – në afat dhe i pranuar ligjërisht për identifikim;
- në gjendje të mirë fizike – pa dëmtime, grisje apo deformime;
- i lexueshëm nga kamera gjatë skanimit – me tekst dhe fotografi të qarta, pa reflektime apo mjegullim.

Identifikimi elektronik – Përfunduar me sukses


Ekranet paraqet konfirmimin se identifikimi elektronik është përfunduar me sukses.

Ky mesazh informon klientin se verifikimi biometrik dhe validimi i të dhënave janë kryer me sukses nga sistemi dhe platforma Namirial.

Pasi ky hap validohet, klienti udhëzohet të vijojë me nënshkrimin e dokumenteve të nevojshme për finalizimin e kredisë.

Për të vazhduar, klienti duhet të:

- klikojë opsionin “Firmos dokumentet”, i cili aktivizon procesin e nënshkrimit elektronik;
- shtypë butonin “Vazhdo” për të kaluar në hapin pasues.



Nënshkrimi elektronik (firmosja e dokumenteve)

Pas përfundimit të identifikimit elektronik, klienti vijon me procesin e nënshkrimit elektronik të dokumenteve të kredisë.

Në këtë faqe, klientit i kërkohet të konfirmojë nënshkrimin duke futur kodin OTP (fjalëkalim njëpërdorimësh), i cili dërgohet në pajisjen e tij të regjistruar.

Ky kod garanton që vetëm mbajtësi legjitim i llogarisë mund të përfundojë nënshkrimin dhe siguron integritetin e procesit.

Mesazhi i konfirmimit

Në ekran shfaqet një dritare (pop-up) me mesazhin:

“Sign with a disposable remote certificate”


Ky mesazh informon klientin se nënshkrimi elektronik realizohet përmes një certifikate të përkohshme në distancë, e cila përdoret vetëm një herë dhe ka vlefshmëri të kufizuar.

Në të njëjtën kohë, klientit i dërgohet një mesazh SMS me kodin OTP, i cili duhet të vendoset brenda afatit të përcaktuar.

Hapat për konfirmim

Klienti duhet të:

- vendosë kodin OTP në fushën përkatëse për të finalizuar nënshkrimin;
- verifikojë që pajisja e tij (telefon celular) ka marrë kodin pa probleme.



Detajet e nënshkrimit elektronik

- Gjatë procesit të nënshkrimit, shfaqen informacionet e mëposhtme:
- Transaction ID dhe koha e vlefshmërisë së saj;
- të dhënat e certifikatës dhe të nënshkruesit;
- data dhe ora e nënshkrimit;
- adresa IP e pajisjes.

Kodi OTP dhe përfundimi i nënshkrimit

Për të përfunduar nënshkrimin elektronik, klienti duhet:

- të presë njoftimin me kodin OTP në pajisjen e regjistruar (telefon ose e-mail, sipas konfigurimit);
- të vendosë kodin brenda afatit të përcaktuar;
- të sigurohet që kodi është i saktë për të vijuar procesin.

Nëse kodi është i pasaktë ose skadon, klienti duhet të kërkojë një kod të ri për të vazhduar.


Në rast skadimi të OTP-së Sistemi nuk e ridrejton automatikisht klientin për rifillimin e procesit.

Hapat që duhet të ndjekë klienti

- të hapë e-mailin me njoftimin fillestar për nënshkrim;
- të klikojë sërish linkun e nënshkrimit të dokumenteve;
- sistemi gjeneron një sesion të ri nënshkrimi (sesioni i mëparshëm nuk është më i vlefshëm);
- të vijojë procesin standard të nënshkrimit deri në përfundim.

Përfundo Dokumentin

Klienti pranon përfundimin e procesit të firmosjes duke klikuar mbi butonin “Përfundo”.




Shkarkimi i dokumenteve të firmosura

Pas përfundimit të nënshkrimit, klienti drejtohet te ikona “Shkarkoni dokumentin”. Klienti mund të shkarkojë dhe ruajë dokumentet në kompjuter ose telefon.

Dokumentet e disponueshme janë:


- Informacioni Parakontraktor për Kreditë Konsumatore të Pasiguruar
- Kontrata e Kredisë Konsumatore të Pasiguruar
- Klauzola e Pëlqimit Paraprak
- Informacion – Kushtet për sigurimin e jetës
- Plani i amortizimit

Pasi dokumentet shkarkohen, klienti klikon butonin “Mbyllni dhe vazhdoni”, i cili përmbyll procesin e nënshkrimit dhe e çon klientin në hapin përfundimtar të aplikimit.



Konfirmimi final

Pamja përfundimtare i tregon klientit se procesi i nënshkrimit të dokumenteve është kryer me sukses.




Firmosja – Përfunduar me sukses

Pasi dokumentet janë nënshkruar elektronikisht, sistemi konfirmon se firmosja është kryer me sukses dhe të gjitha dokumentet e nevojshme janë finalizuar.

HAPI 6: STATUSI PËRFUNDIMTAR

Kredia disbursohet në llogarinë e klientit

Në këtë seksion final, klienti njoftohet se Kredia Konsumatore e Pasiguruar është disbursuar në llogarinë e tij.



Ky ekran përfaqëson:

- mbylljen e suksesshme të aplikimit për kredi;
- konfirmimin zyrtar të disbursimit;
- përfundimin e procesit digjital të aplikimit.

Dërgimi automatik i dokumenteve të firmosura

Platforma mbështet dërgimin automatik të dokumenteve të firmosura elektronikisht në adresën e e-mail-it të klientit.

Pasi përfundon procesi i nënshkrimit:

- sistemi gjeneron dokumentet finale;
- dokumentet dërgohen automatikisht në inbox-in e klientit.

Ky funksionalitet siguron që klienti të ketë një kopje të menjëhershme, të saktë dhe të ruajtur në mënyrë të sigurt, pa pasur nevojë për ndërhyrje manuale.

7. NDËRPRERJA E PROCESIT OSE SHKËPUTJA E PLATFORMËS

Ky seksion përshkruan mënyrën e reagimit të platformës në rastet kur:


- lidhja me internetin ndërpritet;
- sesioni i përdoruesit ndërpritet gjatë aplikimit.

7.1 Hapi i parë – Shkëputja nga interneti

Në rast ndërprerjeje të lidhjes, shfaqet faqja standarde e shfletuesit me mesazhin:

“Looks like you’re not connected to the internet”

Kjo tregon se, në momentin e ndërprerjes, procesi i aksesit në platformë ndalet menjëherë.



7.2 Hapi i dytë – Rikthimi i lidhjes

Pasi lidhja me internetin rikthehet, platforma e ridrejton klientin në faqen e hyrjes, ku kërkohet vendosja e:

- emrit të përdoruesit;
- fjalëkalimit.

Kjo ndodh sepse sesioni i mëparshëm është ndërprerë gjatë humbjes së lidhjes, dhe sistemi kërkon ri-autentikim për të garantuar sigurinë dhe vazhdimësinë e procesit.

Produkte



Kredi Konsumatore e Pasiguruar

Ke një ide, dëshirë apo nevojë që kërkon



Kartë Kredi


Kërkon një zgjidhje të përshtatshme për

7.3. Hapi i tretë– Vazhdimi i aplikimit të mbetur

Pas hyrjes në sistem, platforma nuk e rikthen klientin automatikisht në hapin ku ishte ndërprerë, por shfaq faqen standarde të produkteve.

Kjo sjellje është e qëllimshme dhe lidhet me menaxhimin e sesioneve pas ndërprerjes, me qëllim garantimin e:

- sigurisë së të dhënave;
- integritetit të procesit të aplikimit.





THANK YOU

APRIL 2026

